# DËSHMI ARKIVI

**A-446664**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ledri Vula i dedikon tatuazh të veçantë Poem Blu, vajza i “përgjigjet” me gjestin e ëmbël |
| ADRESA | `https://piranjat.al/showbiz/ledri-vula-i-dedikon-tatuazh-te-vecante-poem-blu-vajza-i-pergjigjet-me-g-i104254` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 16:11:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 15:54:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `efb722fd8f61eb80fa638fe9a8c5d4de40829d79814a3bf185ef9a15c6ad9c52` |
| TEKSTI | `b085dc39354c3e0f6d5934ef38957304f794fbef54c3ee0b6ce24ea67dce6309` |
| PAMJA | `295fe3369177c5011d6f87c06a0cccda6ccd95d04c84013524588f88f6ff7a0c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `977d177a5da654cbbd71a08e4b09a63863a74d42b94782f67c97c0047261ae7b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/977d177a5da654cbbd71a08e4b09a63863a74d42b94782f67c97c0047261ae7b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SHOWBIZ

# Ledri Vula i dedikon tatuazh të veçantë Poem Blu, vajza i "përgjigjet" me gjestin e ëmbël

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 17:54





Një ditë e rëndësishme për Poem Blu u kthye në një kujtim të paharrueshëm edhe për babain e saj, Ledri Vulën. Artisti ka ndarë në rrjetet sociale disa momente nga koha e kaluar me të bijën, teksa vogëlushja po përjeton një prej etapave të para të rëndësishme të fëmijërisë, nisjen e shkollës.

Mes momenteve të tyre së bashku, vëmendjen e ndjekësve e mori një detaj mjaft personal.





Ledri ka vendosur të fiksojë në trup lidhjen me vajzën e tij përmes një tatuazhi të ri. Dizajni është frymëzuar nga një vizatim tipik fëmijëror, ku shfaqen dy figura të thjeshta, një baba dhe vajza e tij. Pikërisht thjeshtësia e këtij vizatimi e bën edhe më domethënës gjestin e artistit, duke e kthyer në një simbol të marrëdhënies së tyre.





Por duket se Poem Blu nuk kishte ndërmend të mbetej vetëm spektatore. E vogla ka dashur të bëjë edhe ajo një tatuazh si babai i saj dhe, për ta bërë dëshirën realitet në mënyrë të përshtatshme për moshën e saj, ka vendosur në krah një tatuazh të përkohshëm me letër ngjitëse. Me buzëqeshjen në fytyrë dhe krahun e ngritur përpara kamerës, Poem Blu ka pozuar krah të atit, duke e bërë edhe më të veçantë momentin.

Një gjest i vogël nga vajza dhe një tatuazh me shumë kuptim nga babai, që tregojnë edhe një herë lidhjen e veçantë mes Ledrit dhe Poem Blusë.

### Galeria fotografike ()







Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.